



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-CA-2022-01

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**
Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Kai Ambos
Gjykatëse Nina Jorgensen

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 16 janar 2023

Gjuha në origjinal: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër për Caktimin e Datës për Shqiptimin e Aktgjykimit të Apelit

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Aleks Uajting

Mbrojtjes së Hysni Gucatit:

Xhonatan Elistan Ris

Mbrojtjes së Nasim Haradinajt:

Tobi Kadman

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT i Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht, “Paneli i Gjykatës së Apelit”, “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”)¹ duke vepruar në bazë të nenit 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 172 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”) lëshon këtë urdhër.

1. Paneli i Apelit ka marrë në shqyrtim apelet nga z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj (bashkërisht, “të akuzuarit”) kundër Aktgjykimit të Trupit Gjykses të shqiptuar më 18 maj 2022.² Më 1 dhe 2 dhjetor 2022, Paneli i Apelit dëgjoi parashtrimet gojore të palëve, që plotësonin dosjet përkatëse të apeleve të tyre.³ Më 3 janar 2023, Paneli i Apelit u njoftua për ato që janë, deri më sot, parashtrimet plotësuese të fundit të palëve.⁴

2. Paneli i Apelit vëren se, në bazë të rregullës 183(2) të Rregullores, “Aktgjykimi i Apelit, ose një përmbledhje e tij, shqiptohet publikisht në emër të popullit të Kosovës, në një datë që iu njoftohet palëve dhe ku palët kanë të drejtë të jenë të pranishme.” Gjithashtu, rregulla 183(1) e Rregullores përcakton se “Aktgjykimi i apelit shqiptohet brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga parashtrimi i fundit prej palëve.”

¹ F00011, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 21 qershor 2022.

² Shih KSC-BC-2020-07, F00611/RED, Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit, 18 maj 2022 (versioni konfidencial u dorëzua më 18 maj 2022); F00035/COR2, Version i Korrigjuar më tej i Dosjes së Apelit të Mbrojtjes së z. Nasim Haradinaj, 2 shtator 2022 (konfidencial, riklasifikuar si publik më 2 shtator 2022) (versioni i pakorrigjuar u dorëzua më 19 gusht 2022, versioni i parë i korrigjuar u dorëzua më 31 gusht 2022,); F00036/RED, Version i Redaktuar Publik i Dosjes së Apelit të Gucatit sipas Rregullës 179(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), 19 gusht 2022 (shpërndarë më 22 gusht 2022) (versioni konfidencial u dorëzua më 19 gusht 2022, shpërndarë më 22 gusht 2022); F00047, Dosje e Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Apeleve të Mbrojtjes, 21 shtator 2022 (konfidenciale, riklasifikuar si publike më 30 shtator 2022); F00065, Kundërpërgjigje e Ridorëzuar e Haradinajt ndaj Dosjes së Përgjigjes së ZPS-së në lidhje me Dosjen e Apelit të Mbrojtjes, 16 tetor 2022; F00067/RED, Version i Redaktuar Publik i Dosjes së Kundërpërgjigjes së Ridorëzuar të Gucatit sipas Rregullës 179(3), 21 tetor 2022 (versioni konfidencial u dorëzua më 17 tetor 2022).

³ Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 14-117; Transkripti, 2 dhjetor 2022, f. 118-215.

⁴ F00102/RED, Version i Redaktuar Publik i Parashtrimit Plotësues të Kërkesës së Haradinajt, 11 dhjetor 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 3 janar 2023).

3. Paneli i Apelit, duke marrë parasysh të gjithë faktorët e përmendur më lart, ka vendosur të shqiptojë Aktgjykimin e Apelit **të enjten, 2 shkurt 2023 në orën 14:00**, në seancë publike.

4. Në përputhje me rregullën 183(2) të Rregullores, Paneli i Apelit udhëzon palët, që deri **të hënën, 23 janar 2023, ora 16:00**, të bëjnë të ditur nëse do të jenë të pranishme gjatë seancës në sallën e gjyqit, apo do të marrin pjesë nëpërmjet videokonferencës. Ekipet e Mbrojtjes udhëzohen ta saktësojnë këtë pikë si për Mbrojtësit ashtu edhe për të akuzuarit.

5. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit:

CAKTON DATËN e shqiptimit të Aktgjykimit të Apelit **të enjten, 2 shkurt 2023, në orën 14:00**; dhe

UDHËZON palët të njoftojnë brenda **të hënës, 23 janar 2023, në orën 16:00**, nëse do të jenë të pranishme në sallën e gjyqit gjatë kësaj seance, sikurse përcaktohet hollësisht në paragrafin 4.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mishelë Pikar,
Kryegjykatëse

E hënë, 16 janar 2023

Në Hagë, Holandë